

VENDIM
Nr. 1, datë 10.3.2016

PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË AGJENCISË PËR ZHVILLIMIN RAJONAL
NR. 2

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 961, datë 2.12.2015, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, të Agjencive të Zhvillimit Rajonal dhe Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal”, neni 6, pika 11, dhe të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, datë 11.1.2016, bazuar dhe në shkresën nr. 7835, prot., datë 9.3.2016, të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë me popullsinë më të madhe, Bordi i Partnerëve për Zhvillim

VENDOSI:

1. Emërimin e z. Arben Skënderi, si drejtor i Agjencisë për Zhvillimin Rajonal nr. 2.
2. Ngarkohet kryetari i Bordit të Agjencisë për Zhvillimin Rajonal nr. 2, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I BORDIT
Vangjush Dako